



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA III

Sesioni Vjeshtor

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr. 54.

Prishtinë, më 21.09.2010 ora 11:00.

Ndërtesa e Kuvendit, salla N – 225 .

**PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ARSIM, SHKENCË, TEKNOLOGJI,
KULTURË, RINI DHE SPORT**

Në mbledhje morën pjesë : Arsim Rexhepi, kryetar, Drita Kadriu, Enis Kervan, Donika Kadaj – Bujupi, Hestet Cakolli, Mark Krasniqi dhe Dragan Dimiq.

Mungoi : Ismajl Kurteshi.

Nga stafi mbështetës i komisionit : Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi Arsim Rexhepi, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 13.07.2010 dhe 14.07.2010,
3. Shqyrtimi i Planit të punës,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi - konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi - kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen lidhur me pikat e rendit të ditës.

Hestet Cakolli – kërkoi sqarim lidhur me organizimin e konferencës ndërkombëtare të arsimit e cila është paraparë të mbahet gjatë muajit tetor.

Drita Kadriu – kërkoi nga kryesuesi sqarim lidhur me pikën e tretë të rendit të ditës duke e pasur parasysh se plani i punës është miratua në fillim të vitit nga komisioni.

Kryesuesi – i njoftoi anëtarët e komisionit se lidhur me organizimin e konferencës ka qenë i angazhuar dhe ka realizuar shumë takime gjatë muajit korrik dhe gusht. Ai po ashtu para anëtareve të komisionit theksoi se është bërë kërkesë me shkrim për mbështetje materiale nga

ana e Kuvendit mirëpo një gjë e tillë nuk ka gjetur mbështetje. Kemi realizuar kontakte edhe me Ambasada dhe kam kërkuar mbështetje materiale për organizimin e konferencës, njëra prej ambasadave që kemi realizu kontakte është Ambasada e SHBA-së nga e cila me është kërkuar që përmes një OJQ-je të dorëzohet projekti lidhur me organizimin e konferencës. OJQ Instituti për Politika dhe Media ka përgatitur projektin në tërësi lidhur me organizimin e konferencës por në momentin e fundit projekti nuk është mbështetur.

Tani përmes ambasadës gjermane jemi në kontakt me GTZ-në dhe MASHT-së që së bashku të organizojmë konferencën ndërkombëtare të arsimit.

Sa i përket qështjes së ngritur lidhur me shqyrtimin e planit të punës, kryesuesi i njoftoi anëtarët e komisionit se në takimet me ministrat e fushes që mbulon komisioni është dashur të shqyrtohen disa çështje si strategjia e sportit, dokumentacioni mbi themelimin e Universitetit të Prizrenit.

Drita Kadriu – kerkoi sqarim lidhur me mos ndryshimin e emrave të anëtareve të komisionit të cilet gjenden në planin e punës së komisionit.

Adem Hajdaraj – kërkoj që të informohet nga kryetari i komisionit se ku ka mbetë çështja e pensionimit të mësimitdhënësve universitar.

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 13.07.2010 dhe 14.07.2010.

Kryetari/Kryesuesi - konstatoi se Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 13.07.2010 dhe 14.07.2010 pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i planit të punës.

Kryesuesi - lidhur me këtë pikë tha se plani i punës është diskutuar edhe me parë në komision. Sa i përket projektligjeve që është dashur të procedohen e të cilat nuk kanë arritur, në si Komision duhet të debatojmë se si ta plotësojmë këtë plan dhe të përgatitemi për punët që na presin. Ai theksoi se ditë me parë ka patur takim me rektorin z.Mujë Rugova dhe nga ai është informuar se rektorati do të drejtohet komisionit me një shkresë me qëllim të tejkalimit të disa sfidave me të cilat ballafaqohet menaxhmenti aktual i Universitetit të Prishtinës.

Adem Hajdari – theksoi se duhet të korrigjohet ky plan se ka mbetë shumë pak kohë për me u realizu.

Heset Cakolli - në e kemi diskutua edhe me herët këtë plan dhe në si komision nuk mbajmë përgjegjësi për shumë çështje të cilat nuk kanë ardh në komision nga ministrat e linjës.

Donika Kadaj – Bujupi – konsideroi që është një diskrepancë ndërmjet planit të punës dhe strategjisë legjislativë sa i përket ligjeve, andaj kërkoj që të dërgohet një shkresë dy ministrave me qëllim të informimit të komisionit lidhur me afatet kohore për procedim të projektligjeve në komision.

Drita Kadriu – duke u bazuar në planin e punës, shihet se disa nga aktivitetet e parapara janë përfunduar, si vizita të ndryshme, mbikëqyrje, monitorim, takime.

Mendoj se në kemi përfunduar shumë punë lidhur me raportin e progresit, edhe pse në raportin përfundimtar të komisionit për integritet nuk janë përfshirë shumë çështje të raportit të progresit që në si komision i kemi dërguar.

Anëtarët e komisionit u pajtuan që Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve ti drejtohen me një shkresë përmes së cilës kërkojnë sqarim për afatet kohor të procedimit të projektligjeve sipas strategjisë legjislative.

4. Të ndryshme

Kryesuesi –i informoi anëtarët e komisionit se kohët e fundit në disa kolegje po bëhen punë ilegale siç është Universiteti Ndërkombëtar i Strugës në Prizren, Universiteti Kristal i Tiranës në Prishtinë e po ashtu edhe ngecjet e MASHT-së lidhur me vonesat në procesin e nostrifikimit të diplomave të kolegjeve të licencuara për këtë kemi shumë vërejtje se po ka vonesa gjer një vit.

Donika Kadaj Bujupi – përmendi një rast nga QKUK-së ku një mjek ka pritur me vite të tëra për nostrifikim të diplomës.

Drita Kadriu – shprehu shqetësimin e saj lidhur me procedurat e tejzgjatura për nostrifikim të diplomave dhe me këtë rast propozoi që për këtë çështje të ftohet ministri i MASHT-së për mbledhjen e ardhshme dhe të diskutojmë këtë çështje.

Adem Hajdari - ka raste që në vendet e rajonit edhe është paguar diploma dhe në këto raste kërkohet kohë me e gjatë për verifikim.

Anëtarët e komisionit u pajtuan që për mbledhjen e ardhshme të komisionit të ftohet Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë z.Enver Hoxhaj dhe të diskutohen këto çështje :

- Nostrifikimi i diplomave,
- Kolegjet ilegale,
- Vulat e diplomave.

Mbledhja përfundoi në orën 11:55.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

**Kryetari/ Kryesuesi i Komisionit
Arsim Rexhepi**
